



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:058602
Datë: 08.08.2022
Numri i dokumentit: 03305021

APS.nr.20/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti Special, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Bashkim Hyseni kryetar, Burim Ademi dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Alba Makolli, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.B., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe mbrojtësit të akuzuarit R.B. avokati Emrush Kastrati, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – departamenti Special, PS.nr.12/21 të dt.14.04.2022, në seancën e kolegjit me datë 28.07.2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit R.B., Av. Emrush Kastrati, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.12/2021 të datës, 14.04.2022, NDRYSHOHET ashtu që:

Në mbështetje të nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-ës,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Që nga data 06.07.2018 në vazhdimësi, në cilësinë e personit zyrtar – kryetar i Komunës së Malishevës, me dashje dhe duke shfrytëzuar autoritetin zyrtar ka tejkalluar kompetencat e tij duke i shkaktuar dëm shtetasit R.R. dhe Buxhetit të Komunës, së Malishevës, në atë mënyrë që:

Me datë: 07.11.2018 ka caktuar lokacionin për ndërtimin e shkollës në fshatin ..., që fillimisht i kishte premtuar të dëmtuarit që të hyje në marrëveshje për shkëmbimin e tokës me qëllim të ndërtimit të shkollës në fshatin ... ku pjesë e objektit të shkollës ishte paraparë të ndërtohet në prone private, duke anashkaluar procedurat e Kuvendit Komunal të Malishevës, në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit 04/L-144 për dhënien e tokës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa me date 23.10.2018 ka nxjerr aktvendim nr.01/1527 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve, në fshatin ... në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P.7231-0009-01476-0 në vendin e quajtur “Halishta – shkollë” pronë publike në emër të shkollës fillore, “ Bajram Curri” në ... në sipërfaqe prej 6918 m², duke anashkaluar vendimin Nr.02/135 të datës 04.05.2018 të nxjerr nga Kuvendi Komunal i Malishevës që salla e sportit në fshatin ... të ndërtohet në oborrin e SHFMU “ Visar Krasniqi” megjithatë aneksi i shkollës – salla sportive nuk u ndërtua asnjëherë.

Me datë 26.10.2018 ka nxjerrë aktvendimin për bartjen e mjeteve financiare nga një program në një program tjetër apo nga një kod në një kod tjetër ekonomik në kundërshtim me dispozitat e ligjit 03/L-040 për vetëqeverisje lokale në atë mënyrë që mjetet financiare nga Kodi e më pastaj të njëjtat mjete i ka përdorur për pagesën e detyrimeve financiare të komunës ndaj personave të tretë, pa miratimin e Kuvendit Komunal.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale, keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e buxhetit të shtetit.

Ankesa e Prokurorisë speciale konsiderohet jo lëndore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, ka marrë aktgjykimin PS.nr.12/21 të dt.14.04.2022, me të cilin të akuzuarin R.B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit do t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 5000 (pesëmijë) euro, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse, i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë dënimin me gjobë, gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur 1 (një) ditë burgim me 20 (njëzet) euro të gjobës.

Është obliguar i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet procedurale gjyqësore aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 (njëqind) euro, ndërsa shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të cilat duhet t'i paguajë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari B.R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, me propozim që të aprovohet ankesa, ndërsa aktgjykimi të ndryshohet sa i përket dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.B. avokati Emrush Kastrati për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa, dhe i akuzuari të lirohet, apo të anulohet aktgjykimi dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtresën me shkrim PPA/I.nr.261/22 të datës 26.05.2022, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, dhe aktgjykimi të ndryshohet sa i përket vendimit për dënim, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim në kohëzgjatje më të madhe, ndërsa të refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit R.B. avokati Emrush Kastrati.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale dhe mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësit të të akuzuarit është e bazuar ndërsa ankesa e prokurorisë është jo lëndore.

Pretendimet ankimore.

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, theksohet se aktgjykimi nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë është aplikuar ligji penal, me rastin e shpalljes fajtor të akuzuarit. Mirëpo, dënimi i shqiptuar është i butë, nuk i përgjigjet përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërisë shoqërore, nuk do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së. Nuk është vlerësuar drejtë, fakti se i akuzuari e ka kryer veprën penale në cilësinë e personit zyrtar si Kryetar i Komunës së Malishevës. Po ashtu, është dashur të merret parasysh faktin se këto vepra penale janë në rritje, prandaj është dashur të shqiptohet dënim efektiv. Në këto rrethana, është propozuar që gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin për sa i përket dënimit.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit R.B. avokati Emrush Kastrati, theksohet se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12, nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 par.7 dhe 8 të KPP-së. Nuk janë sqaruar, qartë dhe në mënyrë të plotë faktet dhe për çfarë arsye konsiderohen si të vërtetuara, se dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit, se cilat ishin provat vendimtare që i akuzuari të shpallet fajtor, gjatë arsyetimit të aktgjykimit përshkruhen provat e administruara. Arsyetimet, e gjykatës janë kontradiktore sepse i akuzuari nuk ka pas dashje për ta kryer veprën penale, sepse i vetmi qëllim i tij ishte ndërtimi i shkollës për nxënësit e fshatit ..., e jo përfitimi i dikujt në mënyrë të kundërligjshme apo shkaktimi i dëmit. Sipas ankesës, është shkelur neni 20 i KPRK-së, sepse mungon lidhja shkakore mes veprimit ose mos veprimit si dhe pasojës. Po ashtu, nuk është vërtetuar dashja dhe qëllimi i kryerjes së veprës penale. Sipas ankesës, nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale, sepse nga provat e administruara rezulton e kundërta, për faktin se i njëjti ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore. Anashkalimi i procedurave administrative, siç ishte rasti i asamblesë komunale lidhur me dhënien ose jo të pronës publike si kompensim për pronën private në të cilën pjesërisht u ndërtua shkolla fillore, ndërsa i akuzuari nuk bëri ndërrimin e pronës publike me atë private, sepse këtë e bllokoj asambleja komunale e Malishevës. Pastaj, ndryshimi i lokacionit me vendimin e kryesisë së fshatit ... për ndërtimin e sallës sportive si dhe bartja e mjeteve prej një kodi në kodin tjetër, nuk do të thotë se janë veprime inkriminuese, sepse edhe sipas këtyre dispozitave askund nuk potencohet se mos respektimi i dispozitave të ligjeve administrative, përbëjnë vepër penale, e në anën tjetër askund nuk është potencuar se Komuna e Malishevës të jetë dëmtuar financiarisht, por e kundërta në rastin konkret fituan shkollën e re, nxënësit e fshatit ..., dhe detyrimi i komunës që në të ardhmen ta kompensojë pronën private me atë publike. Sa i përket sallës sportive, nuk ishte i akuzuari që e vendosi

lokacionin, por ishte kryesia e fshatit, ndërsa vendimi i asamblesë komunale rezulton se ishte në kundërshtim me vullnetin e shumicës së qytetarëve të fshatit ..., nëse dikush e ka shkel ligjin në rastin konkret, e ka shkel asambleja komunale kur nuk e përfilli vullnetin e shumicës së qytetarëve. Sa i përket bartjes së mjeteve prej një kodi në kodin tjetër, edhe në këtë drejtim dispozitat ligjore të Ligjit për menaxhimin e financave publike, nuk përcaktojnë se ndërrimi i destinimit të parasë publike dhe përdorimi i saj nuk përbëjnë veprë penale, pra me asnjë rast i akuzuari nuk ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme dhe nuk është dëmtuar, por përkundrazi është mbrojtur buxheti i Komunës së Malishevës. Po ashtu, fakti se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale, tregon edhe dëshmia e dëshmitarit B.R., i dëgjuar si dëshmitar, i cili ia ka dhënë pëlqimin që një pjesë e shkollës fillore, të ndërtohet në pronën e përbashkët të vëllezërve të tij. Tutje, nga dëshmia e dëshmitarit RR.M. dhe M.M., është vërtetuar fakti se i akuzuari disa herë e kishte dorëzuar kërkesën në asamblenë Komunale të Malishevës, që tani B.R.t përkatësisht vëllait të tij t'i kompensohet prona e tij me pronën publike të komunës, përkundër faktit se kishte pronë publike po në afërsi të pronës ku ishte ndërtuar shkolla fillore, por asambleja komunale e kishte refuzuar kërkesën e të akuzuarit. Është vërtetuar se dëshmitari B.R. nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, sepse pëlqimin e kishte dhënë personalisht pasi ishte konsultuar me vëllezërit e tij në Zvicër. Vlerësimi i gjykatës, që i akuzuari e ka dëmtuar pronën publike nuk qëndron dhe nuk është dëmtuar as pronari privat. Nuk qëndron fakti se i akuzuari B.j e paska caktuar vet lokacionin e ndërtimit të shkollës. Sipas dëshmisë së dëshmitarit M.M., tani në përbërjen e re të asamblesë së Komunës së Malishevës, është futur në procedurë kërkesa e ish kryetarit B.j, që prona private t'i kompensohet me pronë publike vëllait të B.it, këtu R.R.t. Po ashtu, nuk qëndron vlerësimi i gjykatës se i akuzuari ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Kuvendit Komunal të dt.04.05.2018 me nr.02/135 për ndërtimin e sallës sportive në oborrin e shkollës fillore, pra në rastin konkret ishte humbur vetëm një mundësi për ndërtimin e sallës sportive, dhe jo që ishte shkaktuar dëm material. Sipas dëshmive të dëshmitarëve N.SH. dhe B.K., të dy zyrtarë të Zyrës së Prokurimit Publik KK Malishevë, është vërtetuar fakti se nuk ka pasur shkelje të procedurave të prokurimit publik, gjatë tenderimit dhe pas kësaj faze. Po ashtu, nga deklarata e dëshmitarit V.M., drejtor i financave të KK Malishevës, është vërtetuar se procedurat për zotimin e mjeteve dhe ndërtimin e shkollës fillore, ishin zbatuar në pajtim me dispozitat ligjore dhe ndryshimi i kodeve financiare – bartja e mjeteve prej një kodi në kodin tjetër me të cilat ishin kryer detyrimet financiare, siç ishin pagat jubilarë, shujtat dhe vendimet gjyqësore nuk kanë dëmtuar parinë publike. Sa i përket ekspertizës së ekspertit financiar Agim Sheqiri, është vërtetuar se nuk është dëmtuar buxheti i Kosovës. Asnjëri nga dëshmitarët – udhëheqësit e grupeve të partive politike A.M., V.K. dhe A.K., dhe kryesuesi i KK RR.M., ka

rezultuar se asnjëri nga dëshmitarët nuk kanë dëshmuar dhe nuk kanë ditur se a është dëmtuar paraja publike – buxheti i Komunës së Malishevës, dhe dëshmitë e tyre kishin ngjyrimë politike. Mendimi i ekspertit se i akuzuari nuk i ka respektuar dispozitat ligjore, të cilin mendim gabimisht e ka pranuar gjykata, janë dispozita ligjore të ligjeve administrative, por me vendimet që ka nxjerrë i akuzuari vërtetohet se nuk është dëmtuar Buxheti i Komunës së Malishevës, dhe as ky personalisht e as ndonjë person tjetër, nuk kishte përfituar në mënyrë të kundërligjshme dhe i vetmi që kishte fituar në pajtim me ligjin, përkatësisht nxënësit e fshatit të cilët kishin përfituar një shkollë të re e ndërtuar sipas standardeve të kohës, kurse nuk ishte faji i të akuzuarit që nuk u ndërtua salla sportive, sepse ishte kryesia e fshatit që nuk ishte pajtuar fillimisht me lokacionin, e pastaj këtë fakt e kishte dëmtuar edhe vendimi i asamblesë komunale që kishte vendosur lokacion tjetër në kundërshtim me vullnetin e kryesisë së fshatit, dhe se në rrethanat e tilla investitori Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, nuk kishte lejuar mjete financiare, për ndërtimin e sallës sportive, pra ishte humbur një mundësi për të përfituar ndërtimin e sallës sportive, e jo që ishte dëmtuar paraja publike. Po ashtu, është dashur të aplikohet neni 3 i KPRK-së, parimi in dubio pro reo. Në këto rrethana, është propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, ka vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtjes dhe ka gjetur se, gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë është vërtetuar gjendja faktike, që mbrojtja pretendon, andaj kolegji i kësaj Gjykate këto pretendime ankimore i gjen të bazuara.

Kolegji vlerëson se i pandehuri ngarkohej për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në vazhdim dhe atë për tri veprime konkrete se:

- a). “kishte hyrë në marrëveshje duke i premtuar të dëmtuarit për shkëmbimin e tokës me qëllim të ndërtimit të shkollës në fsh ..., ku një pjesë e objektit ishte paraparë të ndërtohet në pronën private, në kundërshtim me dispozitat ligjore e duke anashkaluar procedurat e kuvendit komunal të Malishevës.
- b).”i pandehuri ngarkohej se në kundërshtim me dispozitat ligjore ka marr aktvendim për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ... në shkollën fillore Bajram Curri, përkundër se vendimi i kuvendit komunal nr.02/135 i datës 04.05.2018, kishte përcaktuar se salla e sportit duhet te ndërtohej në oborrin e shkollës Visar Krasniqi në fshatin
- c). “ngarkohej se me date 26.10.2018 ka marr vendim për lëvizjen e mjeteve monetare të buxhetit nga një kod në kodin tjetër në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat mjete i ka shfrytëzuar

për pagimin e detyrimeve të komunës ndaj personave të tretë, pa miratim nga ana e kuvendit të komunës.

Kolegji vlerëson, se provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor vërtetojnë tërësisht gjendje tjetër faktike nga ajo që gjykata e shkallës së parë ka konstatuar dhe ka konkluduar në raport me përgjegjësinë penale të të pandehurit.

Siç rrjedh nga provat që gjinden në shkresat e lëndës që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale janë dëgjuar dëshmitarët B. Rubi, V.K., N.SH., B.K., A.K., RR.M., A.M., V.M., M.M..

Dëshmitari B.R., në deklaratë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 24.01.2022, fillimisht ka deklaruar se qëndron pran deklaratave të dhëna në Polici me datë 19.07.2019 dhe datë 03.03.2021, dhe ka shtuar se disa zyrtar të Komunës kur janë dalë në teren në fshatin ...-....., kanë kërkuar prej familjes tonë që të lirohet një pjesë e pronës prej 8 ari e gjysmë për ndërtimin e shkollës, fillimisht nuk ka pranuar, pasi që ka jetuar në bashkësi familjare, janë 5 vëllezër, dhe tre vëllezërit që janë jashtë vendit e kanë shtyrë me pranua, se i kanë thënë se është marre mos me dhënë toka me ndërtua shkolla duke marrë parasysh se dhe ai punon si mësues në atë shkollë, vëllezërit kanë pranuar me u ndërtuar shkolla në atë pjesë të pronës me kusht që me u kompensuar jo më pare, por me tok të njëjtë, aty afër, pasi që ngjit me tokën e tyre është prona shtetërore dhe për këtë kanë pasur marrëveshje verbale me kryetarin R.B., e sa i kujtohet aty prezent ka qenë dhe kryesuesi i Kuvendit RR.M., që të bëhet ndërtimi i shkollës dhe të bëhet kompensimi me pronë tjetër dhe janë pajtuar që çështja të shkoj përmes asamblesë, i ka pohuar kryetarit se nuk pranojnë 1 ari me 1 ari me i kompensua, por pranojnë vetëm kompensimin 3 ari për 1 ari, kryetari nuk ju ka premtua për çfarë vlere të tokës do të kompensohet toka e tyre, mirëpo që kompensimi do të kryhet dhe vetë ka qenë i bindur se shteti nuk mundet me ia marrë pasurinë e mos me i'a dhënë asnjë kompensim dhe se lidhur me këtë çështje me kryetarin tani të akuzuarin R. B., ka biseduar njëherë në zyre të tij dhe njëherë në fshat, në oborrin e shkollës dhe janë pajtuar që procedura e kompensimi të shkoj përmes asamblesë Komunale. Më tutje ka sqaruar se tani pas ndarjes së tokës, toka ku është ndërtuar sholla, është në emër të vëllait të madh R.R., mirëpo që në kohen kur është marr toka për ndërtim, të gjithë vëllezërit tjerë kanë qenë jashtë vendit, dhe ai e ka konsideruar veten si pronar të saj, dhe arsyeja pse është marr prona e tyre, për ndërtim të shkollës është se pozicioni në vendin ku është shkolla, pasi që ku është prona shtetërore është pozita tepër e pjerrët dhe është e pa mundshme me ndërtua shkollën aty sepse

është e ngushtë dhe shumë e pjerrët, ndërsa shkollë të vjetër që është edhe sot funksionale, nuk i përmbush kërkesat sepse punon në dy ndërrime, ka pas mungesë të hapësirës, ndërsa që shkolla e re ende nuk është funksionale, vetëm inventari i mungon. Po ashtu ka shtuar se me ndërtimin e shkollës, ju është vështirësuar qasja pasi që duhet të kalojnë nëpër pronë të shtetit, për të lidhur me rrugë nga shtëpia e tyre, pastaj, duke qenë se shkolla është vetëm 20 metra nga shtëpia e vëllai të tij, dëgjohet zhurma e nxënëse, por sido që të jetë, presion nuk ka pas prej ndokujt për me dhënë tokën, padi për kompensim nuk ka paraqitur sepse është marr veshë me kryetarin, kush e ka iniciuar rastin në gjykatë nuk e din, mirëpo në të ardhmen nëse nuk gjendet zgjidhje për kompensim, atëherë duhet me shkua përmes gjykatës. Në deklaratat e dhënë në Polici me datë 19.07.2019 dhe me datë 03.03.2021, ka deklaruar ngjashëm lidhur me rrethanat për të cila është deklaruar në këtë çështje penale.

Dëshmitari V.K. në deklaratën e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.01.2022, ka deklaruar se është asamblist në Kuvendin Komunal në Malishevë, nga viti 2017, e që gjatë kësaj periudhë ka qenë shef i grupit parlamentar të L...-së, anëtarë i komitetit për politike dhe financa, të cilin komitet e përfaqëson kryesuesi i kuvendit komunal, ndërsa që ai si anëtar i komitetit për politikë dhe financa, detyra e tij kanë qenë harmonizimi i programit të punëve, i pikave të rendit të ditës në seanca, ndërsa që është ekzekutimi që ka të bëjë me çështje financiare, ani pse quhet komiteti për buxhet dhe financë. Më tutje ka shtuar se sa i përket ndërtimit të palestrës sportive, janë zhvilluar dhe takime e konsultime edhe me komunitetin në fshatin ..., ku ka qenë prezent edhe kryetari B.j, Kuvendi me shumica votash ka vendosë që kjo palestër sportive të ndërtohet në shkollën “Visar Krasniqi”, në ..., mirëpo edhe sot e kësaj dite ajo palestër nuk është ndërtua, me arsyetimin se është premtuar të ndërtohet në një shkollë tjetër, për shkak se kanë thënë që ai projekt i ka takua dikujt tjetër dhe kështu ka mbet pa u ndërtua fare, ndërsa ka dëgjuar për shkollën që është ndërtuar në fshatin ..., që kanë dalë disa problem me pronë, mirëpo nuk ka njohuri se çka ka ndodhur më tutje. Po ashtu ka shtuar se për shkakun se nuk është ekonomist me profesion, nuk është në kompetencën e tij të di se si shkon procedura e lëvizjes së kodeve prej një kodi në kodin tjetër, mirëpo që beson se lëvizja nga një projekt në tjetrin mund të bëhet vetëm nga Kuvendi Komunal, pasi që më parë është diskutuar në komitetin për politikë dhe financa, nga i cili komitet edhe rrjedh rekomandimi që votohet në Kuvend. Nuk i është kujtuar ndonjë projekt konkret, mirëpo që ka pasur vër ankesa nga komiteti për politikë dhe financa për raportin vjetor për buxhet dhe financa për 2018, për shkak të mos implementimeve të disa projekteve, largimit të disa projekteve devijimit të disa projekteve tjera, dhe se përgjegjës për mos implementimin e projekteve në rastin konkret palestra sportive, apo mos ndërtimin e rrugës

është përgjegjës ekzekutivi për ta kryer secilin projekt që e miraton shumica e kuvendit mbrohet me ligj dhe me rregullore, dhe se ka pas shumë projekte ku në vend të një rrugë është shtrua një rrugë tjetër, se projektet që nuk janë realizuar fare ose nuk janë realizuar me kohë. Ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës të dhënë në polici me datën 06.05.2019, në të cilën deklaratë ka deklaruar ngjashëm sikurse edhe në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Dëshmitari N.SH. në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.01.2022, ka deklaruar se në aktvendimin e quajtur për procedura të prokurimit të protokolluar me datë 24.07.2018. me nr.01/1097 në fq.3 tek, figuron emri i tij si menaxher i prokurimit, mirëpo që nënshkrimi është bërë zyrtarë i prokurimit B.K. me autorizim të kryetari të komunës, pasi që në atë kohë dëshmitari ka qenë në kontratë pune "kontratë mbi vepër" dhe nuk kam pasur të drejtë me nënshkrua kontratë të tillë, ndërsa emri i tij ka qenë, pasi që ka qenë i emëruar si menaxher i prokurimit, po pa të drejtë nënshkrimi të kontratave. Po ashtu ka shtuar sa i përket kontratës me nr.79 e protokolluar me datës 26.10.2018, me nr. 03/123, në të cilën figuron emri i tij si menaxher i prokurimit, situata është e njëjta dhe figuron emri i tij si menaxher i prokurimit, mirëpo pa të drejtë nënshkrimi, pasi që nuk ka pasur pas të drejtë për të nënshkruar, derisa që sot punon me kontratë të rregullt dhe është i licencuar nga viti 2019, po edhe sot ka raste që vendoset emri i tij si menaxher, ndërsa në rast mungese autorizohet dikush për të dhënë nënshkrim në vendin e tij, në vlera të mëdha nënshkruhet dëshmitari dhe ZKA, ndërsa në vlera të vogla dhe të mesme nënshkrimin e jep nënshkrimin i vetëm. Në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me datë 24.02.2021, ka deklaruar ngjashëm për rrethanat për të cilat është pyetur.

Dëshmitari B.K. në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.01.2022, ka deklaruar se që nga viti 2018 është zyrtarë i prokurimit, dhe i kujtohet procedura e prokurimit e zhvilluar lidhur me objektin e shkollës fillore në fshatin ..., në Komunën menaxher i prokurimit ka qenë N.SH., mirëpo pasi që nuk ka qenë i licencuar për nënshkrime, është caktuar nga prokurimi të shënohet emri i menaxherit, ndërsa ai ka qenë i autorizuar nga kryetari që ta ushtroj atë funksion vetëm për nënshkrime që mos me mbet keq deri sa të bëhet certifikimi i menaxherit të prokurimit, pasi që asnjë projekt nuk bëhet pa emër të menaxherit të prokurimit dhe pa nënshkrim të zyrtarit të certifikuar. Më tutje ka shtuar se para që të nënshkruhet kontrata e lartcekur si zyrtar i prokurimit, projekti për ndërtimin e shkollës nuk ka pas para-masat kanë qenë si ka me u duk shkolla, e cila është dashtë me u ndërtua në fshatin ..., mirëpo vendi i saktë i ndërtimit nuk ka figuruar, dhe as që ka qenë kompetencë e zyrës së prokurimit me ditë vendin

e ndërtimit, përderisa ka konstatuar se dosja e tenderit ka qenë në rregull, duke shtuar se ka qenë kërkesa e drejtorisë së arsimit për fillimin e procedurës, e pas kësaj kërkesë bëhen para masat specifike, kërkesa shkon tek kryetari për vendim dhe të Drejtoria e financave për zotim të mjeteve dhe pas 1 viti vjen në prokurim për fillimin e procedurës. Ka deklaruar se mbetet në tërësi pran deklaratës së dhëna në procedurë paraprake, përkatësisht deklaratës së dhënë në Polici me datë 24.02.2021, në të cilën ngjashëm ka deklaruar sikurse dhe në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Dëshmitari A.K. në deklaratën e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.02.2022, ka deklaruar se gjatë mandatit të kaluar ka qenë asamblist në Kuvendin Komunal Malishevës dhe ka qenë anëtarë i komitetit për politika dhe financa nga lëvizja V..., i cili Komitet shqyrton të gjitha dokumentet strategjike, kërkesat të cilat i drejtohen kuvend komunal. Më tutje ka shtuar se për vendimin e datës 26.10.2018, dhe datë 29.10.2018, me numër 01/1559, i nxjerrë nga kryetari i komunës së Malishevës, për bartjen e mjeteve financiare nga një kod ekonomik në kod tjetër, e ka kuptuar nga web-faqja e Komunës së Malishevës, edhe pse sipas ligjit për vetëqeverisje lokale për përgjegjësi të Kuvendit Komunal dhe kryetarit dhe ligjit për financa publike është e qartësuar se bartjen e këtyre mjeteve mund ta bëjë vetëm kuvendi komunal me vendim, e që në rastin konkret nuk ka ndodhur dhe nuk ju është kërkuar asnjëherë nga kryetari që Kuvendi Komunal të vendos lidhur me këtë çështje, ndërsa që nuk i kujtohet të i jetë dorëzuar komitetit për politika dhe financa, ndonjë raport financiar për vitin 2018. Po ashtu ka shtuar se sa u përket projektit me kod 42006 me shumen e realizimit prej 58.901 euro projektin e kanalizimit në rrugën "Mulla Selimi", fshati "Marrali", i cili projekt bart numrin 42007, në vlerë prej 14.000 euro, projekti për ndërtimin e rrugës periferike mini-tran në Malishevë, i cili bart kodit 46723 në vlerë prej 493.000 euro, pas njoftimit lidhur me të njëjtin përmes një raporti financiar nga Drejtoria e Financave, ku ka figuruar si projekti është realizuar në 99 %, ka shkuar personalisht në vendin e ngjarjes, dhe e ka kuptuar se ky projekt nuk është realizuar fare, dhe nga sistemi elektronik i KRPP-së, është kuptuar se një projekt i tillë nuk është tenderuar, e që kjo ka ngritur dyshim, për çka të gjitha materialet i kanë dërguar në Polici. Tutje ka shtuar se lidhur me vendimin e datës 04.05.2018 me numër 02/135 të nxjerr nga Kuvendi Komunal i Malishevës, që ka të bëjë me ndërtimin e sallës sportive në shkollën e mesme e u "Visar Krasniqi" në fshatin ..., ka pasur pakënaqësi lidhur me përzgjedhjen e lokacionit dhe përfshirjen e qytetarëve, kërkesa ka shkuar në Kuvendin Komunal e ku edhe është kuptuar se mjetet për ndërtimin e sajë do të vijnë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, kuvendi marr vendim që lokacioni të jetë në oborrin e shkollës "Visar Krasniqi", vendimi nuk është zbatuar, mjetet të cilat

kanë qenë të ndara prej ministrisë, janë tërheqë nga e njëjta, mjetet e ndara të Komunës janë bartur nga kryetari në projekte të tjera, pa vendim të Kuvendit. Më tutje shtuar se lidhur me ndërtimin e shkollës fillore në fshatin ..., nuk kemi pasur asnjë kërkesë nga kryetari për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e kësaj shkolle, ani pse kur s'ka plan të zhvillimor komunal, atëherë është vetëm kuvendi komunal që merr vendim për ndarjen lokacionit për ndërtimin e objektit dhe tek kur ka filluar policia të hetoj, çështja është sjell në Kuvendin Komunal për ndërrimin e destinimit, ku nuk ka pas të bëj me caktim e lokacionit por me këmbimin e pronës nga prona private në pronë publike, pasi ka filluar ndërtimi i shkollës. Pastaj ka shtuar se ndërtimin e kësaj shkolle nuk e ka justifikuar dhe numri i vogël i nxënësve që vijojnë mësimin në shkollën e cila gjithashtu i ka plotësuar kushtet për mësim-mbajtje, dhe se siç ka rezultuar nga të dhënat e nxjerra nga E-Prokurimi, me rastin e tenderimit, janë përcaktuar vetëm para masa dhe para llogaria, dhe as një element tjetër, përfshirë edhe lokacionin e ndërtimit, e që këto parregullsi janë evidentuar edhe në raportin e auditorit për vitin 2019, ku konstatohet se organi fitues nuk kishte përmbushur kriteret. Edhe në deklaratën e dhënë në procedurë paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me datë 13.05.2019, ka pohuar se qëndron në tërësi, ka deklaruar ngjashëm për rrethanat për të cilat është pyetur.

Dëshmitari A.M., në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 15.02.202 ka deklaruar se prej viti 2017, është në cilësinë e këshilltarit komunal nga radhët e P..-së, d se është në detyrimin e kryetarit të komunës që të raportoj para asamblesë komunale, me raport financiar çdo 3 muaj 6 muaj 9 muaj dhe 1 vjeçar, dhe se i kësaj natyre ka qenë edhe raporti i v 2018, në të cilin raport ju është raportuar për shtrimin e disa rrugëve me asfalt, po në terre nuk qenë të përfunduara ndërsa në raport kanë qenë të shkruara si të përfunduara, e që një n këto projekte ka qenë edhe shtrimi i rrugës nga ura kryesore në drejtim të urës së mini tranzit dhe rruga që lidhet prej xhamisë deri të varrezat e dëshmorëve, dhe një rrugë tjetër ka qenë raportuar nga lagjja Veselaj në drejtim të fshatit ..., këto kanë qenë të raportuara në raport financiar të investimeve kapitale, ndërsa në terren nuk kanë qenë të përfunduara. Më tutje shtuar se është në dijeni për vendimin e kryetarit të kuvendit të Malishevës, të datës 26.10.201 lidhur me lëvizjen e projekteve dhe pagesave të tyre nga një projekt në projektin tjetër, mirë që ky vendim nuk është konstatuar në raportin financiarë që i është dorëzuar atyre, edhe p gojarisht, kanë kërkuar sqarime lidhur me atë vendim, mirëpo që këto sqarime nuk i janë dhënë asnjëherë. Ka theksuar se nuk ka dijeni lidhur me projektin rregullimi dhe mirëmbajtja e palestër të stadiumit futbollit me nr 7644 e cila ka qenë në vlerë prej 59,769.98 euro, mirëpo që ka dije lidhur me ndarjen e një parcele për ndërtimin e sallës së sporteve në shkollën e mesme të ul emri "Visar Krasniqi" në fshatin ..., vendim i marrur

nga kuvendi komunal i Malisheve mirëpo që vendi i ndarë nuk ka qenë jo aty ku ka pas propozua qeveria komunale e asaj kohe përkatësisht propozimi i qeverisjes komunale ka qenë që të ndërtohet afër shkollës së mesme të ulët "Bajram Curri" dhe se kjo ka qenë edhe arsyeja pse ai vendim zbatuar asnjëherë. Po ashtu ka shtuar se ndërtimi i objektit shkollës fillore në fshatin Panoc është bërë pa i respekti procedurat ligjore, asambleja nuk ka marr vendim që ajo zonë të shpallet zonë me interesit veçantë, dyshimet janë se një pjesë e shkollës është ndërtuar në pronë private, dhe është kërkuar ndërrim destinimi i pronës pasi ka fillua ndërtimi objektit, gjë nuk kanë pranuar që kjo kërkesë të futet në rend të ditës në Asamblenë Komunale. Ka theksuar se qëndron në tërësi pranë deklaratës të dhënë në Polici me datë 03.05.2019, ku ka deklaruar njëjtë si dhe në shqyrtim gjyqësor.

Dëshmitari RR.M. në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.02.2022, ka deklaruar se ka qenë kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevë dhe në këtë cilësi në koordinim me kryetarin e Komunës, ka kryesuar Kuvendin Komunal, ka bërë rendin e ditës, e që duke u bazuar në këto rrethana, ka njohuri për vendimin e Kuvendit Komunal të Malishevës të datës 04.05.2018, lidhur me ndërtimin e sallës së sporteve në shkollë fillore të mesme "Visar Krasniqi" në fshatin ... të Komunës së Malishevës, vendim i cili nuk është zbatuar, ndërsa që kërkesa ka qenë e kryetarit që salla të ndërtohet në shkollën "Bajram Curri" në fshatin ..., prandaj nuk është zbatuar vendimi i kuvendit nga ana e kryetarit, ani pse ka qenë detyrim zbatim i këtij vendimi nga Kryetari i Komunes, ekzekutivi ka nxjerrë edhe një vendim që nuk ka drejtë, ka vepruar në mënyrë kundërligjore, ka ndarë lokacion në oborrin e shkollës "Bajram Curri", për me ndërtuar sallën e sportit, edhe pse ekzekutivi nuk ka drejtë me nda lokacion, po kuvendi ka kompetenca me nda lokacion, dhe me këtë rast, nuk është realizuar shuma e ndarë nga Ministria për rini kulturë dhe sport, afërsisht 300.000 euro. Më tutje sa i përket ndërtimit shkollës fillore në fshatin ... Komuna e Malishevës, vendimi për ndërtim është dashur të merret nga kuvendin komunal, e që s'ka ndodhur, është dashur të ndahen mjetet për projekt nuk ka ndodhë, është vendos gur themeli i shkollës pa u nda lokacioni, ani pse fillimisht është dashur të bëhet këmbimi i pronës, pasi që një pjesë e shkollës është ndërtuar në pronën private pa u bërë këmbimi paraprak i pronave, fillimisht është ndërtuar shkolla, pastaj është bërë kërkesa nga kryetari të bëhet këmbimi i pronës pranë kuvendit komunal, kërkesë që është përsëritur 3-4 herë për të hyrë në rend dite, por anëtarët e Kuvendit e kanë refuzuar sepse lënda ka qenë në gjykatë, dhe kur është lënda në gjykatë, kuvendi nuk merret me atë çështje. Më tutje ka shtuar lidhur me vendimin e kryetarit të komunës me datë 26.10.2018, për lëvizjen e mjeteve buxhetore nga një projekt në projektin tjetër për disa projekte të komunës së Malishevës, ky vendim është dashur

të kaloj përmes kuvendit, kryetari është dashtë ta bën bartjen e mjeteve përmes kuvendit. Po ashtu në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në polici me datë 23.05.2019, ngjashëm ka deklaruar për rrethanat për të cilat është pyetur.

Dëshmitari V.M., në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 15.02.2022 ka deklaruar se ka qenë drejtor për financa prej 05.02.2018 deri në fund vit 2018, e edhe gjatë viteve pasuese, dhe se sikurse çdo vit tjetër edhe raporti për vitin 2018, që ka pasqyruar të hyra dhe shpenzimet i është adresuar Kuvendit Komunal, dhe se këto raporte nuk kërkojnë miratimi e kuvendit, vetëm njoftohen-pasqyrohet për anëtarët e kuvendit. Më tutje ka shtuar se vendimi i datës 26.10.2018, i nxjerrë nga ana Kryetari i Komunës të Malishevës lidhur me lëvizjen e mjeteve financiare për pagesa nga një program në programin tjetër ose nga një projekt në projektin tjetër, është nxjerr në interes të Komunës me qëllim që ato mjete të cilat nuk kanë mundur të ekzekutohen për arsye të ndryshme janë destinuar për mi paguar disa obligime brenda kontratave që kanë qenë në atë vit fiskal, ndërsa që nuk e dinë që vendimet e kryetarit duhet mu miratua në Kuvend, për më tepër që konsideron se përmes këtij vendimi është mbrojt paraja publike duke pas parasysh që momentin që nuk paguhen obligimet e komunës me kohë obligimet marrin kosto shtesë përmes procedurave përmbarimore, ndërsa që si rrjedhojë vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore nga sektori arsimit për shujta për paga jubilarë, paga përcjellëse, shumë projekte janë dëmtua pasi që thesari i Kosovës i ka ekzekutua këto mjete për pagat për mësimdhënës nga projektet kapitale për përfituesit mësimdhënësit, duke mos njoftuar Komunën për mjetet që janë marrë nga buxheti i Komunës për mi ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë. Ka shtuar se sa i përket vendimin e dt. 04.05.2018 me nr.02/135 të Kuvendi Komunal me qëllim për ndërtimin e sallës në fshatin ..., sa ka njohuri është kërkuar përcaktimi i lokacionit nga ministria përkatëse dhe ajo pastaj ka kalua në fshatin ..., qëllimi ka qenë të ndërtohet te shkolla "Bajram Curri" sepse shkolla është më e madhe ka numër më të madh të nxënësve, për arsye se në atë fshat janë 3 shkolla, dhe qëllimi ka qenë të jetë në qendër të fshatit në shkollën më të madhe në mënyrë që të jetë e qasshme në mënyrë të barabartë nga i gjithë komuniteti, dhe për disa fshatra më të vogla afër fshatit ... siç është fshati Vërmicë. Ndërsa, nuk ka njohuri se çka ka ndodh me tute. Po ashtu sa i përket shkollës në fshatin ... Komuna e Malishevës, është ndërtuar me kërkesë të banorëve që të kenë kushte më të mira për fëmijët e tyre, duke plotësuar nevojat çoftë për mësim teorik apo praktike, dhe si rrjedhojë është paraqit kërkesa dhe nevoja të ndërtohet ajo shkollë e cila tani më është e ndërtuar dhe të gjithë banorët e atij fshati kanë qenë të kënaqur dhe falënderues për kryetarin B.j për kushtet e krijuara, dhe sa ka njohuri e njëjta shkollë nuk është ende funksionale sepse duhet bërë pajisja me inventarë shkollorë, ndërsa që nuk ka njohuri në çfarë prone është

ndërtuar. Në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me datë 07.08.2018, përmbajtja e të cilës ka deklaruar se nuk i kujtohet se ka elaboruar procedurën e planifikimit dhe miratimit të buxhetit komunal, pastaj procedurën për ndryshimin e tij, e cila përmes Asamblesë Komunale, dhe se në këtë drejtim vendimi i datës 26.10.2018. me nr.01.2559 i nxjerr nga tani i akuzuari R.B., është dashur të miratohet nga Kuvendi Komunal, mirëpo nuk është aprovuar. Ka shtuar se raporti i vitit 2018, si dhe çdo raport tjetër përpilohet mbi bazën e transaksioneve të regjistruara në librat e thesarit, dhe si i tillë nuk pasqyron përfundimin e punimeve, ndërsa që në vijim, ka shpjeguar realizimin e projekteve të veçanta duke sqaruar se ose janë realizuar në vitin vijues ose mjetet janë përdorur në projekte tjera ose ka ekzistuar ndonjë pengesë tjetër, që ka pamundësuar realizimin e tyre.

Dëshmitari M.M. në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 10.03.2022 ka deklaruar se që nga viti 2003 punon në Kuvendin Komunal të Malishevës, nga viti 2017 mban pozitën udhëheqës i shërbimit të Kuvendit Komunal, ndërsa që ka punuar edhe si këshilltar ligjor në zyrën e Kryetarit R.B.. Ka shtuar se vendimin për ndërtimin e shkollës në fshatin ..., e ka marrë Kuvendi i Komunës duke ndarë edhe buxhetin për atë shkollë, dhe në momentin e ekzekutimit të projektit është parë që nuk e ka pasur hapësirën e mjaftueshme për shkollë, pastaj Kryetari bashkë me stafin profesional dhe në bashkëpunim me kryesuesin RR.M., kanë biseduar se duhet të nisët procedura e këmbimit të pronës publike me atë private për t'i lejuar hapësirë të mjaftueshme ndërtimit të objektit të ri, dhe nga kryesuesi është kërkuar që të jpet edhe pëlqimi i palës në këtë rast, është fjala për pronarin faktik të pronës, B.R. pasi që pronari juridik ka qenë vëllai i tij, për çka edhe në zyrën në të cilën kanë qenë prezent dëshmitari, kryesuesi, kryetari dhe pala, në parim është dhënë pëlqimi për fillimin e procedurës, pastaj është bërë kompletimi i të gjitha dokumentacionit të nevojshëm, është bërë 13 herë kërkesë në Kuvend për fillimin e procedurës së këmbimit të pronës publike me pronë private, mirëpo Kuvendi nuk ka lejuar me fut në rend të ditës për arsye politike, për shkak se Kryetari nuk e ka pas shumicën e anëtarëve të partisë së tij në Kuvend për ti siguruar votat e mjaftueshme. Lidhur me këtë rast ka shtuar se në këtë rast është ruajtur interesi publik meqenëse nuk është dëmtuar objektit ekzistues i shkollës, fusha e shkollës, është evituar kosto e dyfishtë e projektit për shkak të terrenit të pa përshtatshëm, e po ashtu nuk është bllokuar pala për shfrytëzimin e pronës së tij për shkak se po të ndërtohej shkolla vetëm në pronën publike, palës në këtë rast B.R. do ti bllokohej qasja në pronën e tij, dhe se edhe qytetari B.R., i cili e kërkon këmbimin pronës, do të i bëhet këmbimi në bazë të ligjit, dhe vlerësimit të Ministrisë së Financave, pasi që pala nuk ka pajtuar që të merr mjete financiare në emër të kompensimit për eksproprijim, ndërsa që në Komunën e Malishevës janë me tepër se

5 shkolla në pronë private, nuk ka pas ankesë, ka pas pajtueshmëri dhe këto parime kanë qenë që janë udhëheq. Më tutje ka shtuar se sa i përket ndërtimit të sallës së sporteve në fshatin ..., qe nga fillimi ka pasur mos pajtime për ndërtimin e asaj sallë në fshatin ... për arsyeje se brenda kryesisë se fshatit disa kanë qenë pro dhe disa kundër për çështjen e lokacionit, e kjo ka qenë rrjedhje se janë keq informuar që palestra e sporteve do të ndërtohet afër shkollës fillore "Visar Krasniqi", më pastaj kryesia e fshatit ka kuptuar se kërkesa e Ministrisë dhe e Komunës nuk është që të ndërtohet salla e sporteve afër shkollës fillore "Visar Krasniqi".

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se deklaratat e këtyre dëshmitarëve janë të ndërlidhura me rrethanat e fakteve te cilat si prova në këtë procedurë penale vërtetojnë këto: fakte mbi mënyrën se si ishin proceduar ndërtimi i shkollës, caktimi i lokacionit te ndërtimit te sallës së sporteve dhe lëvizja e mjeteve nga një kod ne kodin tjetër. Këto prova si të tilla ndërlidhen me faktet që kanë të bëjnë me tejkalimin e kompetencës nga ana e te akuzuarit dhe mos përmbushjen e detyrave nga ana e të akuzuarit, gjë që gjykata për sa i përket vlerësimit të deklaratave të këtyre dëshmitarëve provat e tilla i gjen se janë të besueshme nga se provojnë faktet se i akuzuara R.B. kishte ndërmarr veprime për ndërtimin e shkollës se fshatin ... kur ishte dakorduar me B.R.n si pronar i pronës private, që ai të lëshoj një pjesë të tij të pronës private për ndërtimin e shkollës, po ashtu se i akuzuari nuk e kishte në kompetencë të tij si kryetar i komunës për këmbimin e pronës publike me atë private por që kjo kompetencë sipas ligjit 04/L-144, per dhënie ne shfrytëzim dhe këmbim te tokës se komunës, takonte kuvendit të komunës njëkohësisht se i akuzuari kishte ri caktuar lokacionin për ndërtimin e sallës së sporteve nga vendi i quajtur Halishta shkollë pronë publike ne emër te shkollës fillore Bajram Curri ne oborrin e shkollës SH.F.M.U. Visar Krasniqi, gjë që edhe kjo kompetencë nuk ishte në kompetencat zyrtare të të akuzuarit pasi që kjo kompetencë ishte në kompetencat e kuvendit të komunës, nga deklaratat e këtyre dëshmitarëve po ashtu vërtetohet fakti se i akuzuari kishte autorizuar bartjen e mjeteve financiare nga një program në një program tjetër përkatësisht nga një kod ekonomik në një kod ekonomik tjetër të cilat i kishte përdorur për pagesën e detyrimeve financiare të komunës ndaj personave te tret pa miratim te kuvendit komunal, gjë që edhe kjo kompetencë ishte tejkaluar nga ana e të akuzuarit si kompetencë që duhej të merrte miratimin e kuvendit komunal.

Pra nga deklaratat e dëshmitarëve vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari R.B. në veprimet e tij kishte tejkalim të kompetencave gjegjësisht mos përmbushje të detyrave në përputhje me dispozita ligjore që i përcaktoheshin si kompetenca kryetarit të komunës.

Deklaratat e dëshmitarëve përveçse provojnë faktet e tilla sa i përket tejkalimit të kompetencave dhe mos përmbushjes së detyrave ato janë të besueshme nga fakti se janë të ndërlidhura dhe njëkohësisht kanë edhe mbështetje në provat materiale gjegjësisht në vendimin e kuvendit komunal numër 02/135 të datës 04.05.2018 të nxjerr nga kuvendi komunal për vendin e ndërtimit të sallës së sporteve në pronën publike të shkollës fillore Bajram Curri dhe po ashtu vendimin e nxjerr mbi lëvizjen e mjeteve të datës. 26.10.2018 nga ana e të akuzuarit që kishte lejuar lëvizjen e mjeteve monetare nga një kod në kodin tjetër.

Përkundër faktit se kolegji ka gjetur se mbi bazën e këtyre provave të lartë theksuara vërtetohet se i akuzuari ka tejkaluar dhe njëkohësisht nuk ka përmbushur detyrat e tij zyrtare për të përgjegjësia penale e të akuzuarit për veprën penale të keqpërdorimit apo të autoritetit zyrtar tejkalimi i kompetencave apo mos përmbushja e detyrave duhet të vërtetohet se i akuzuari këtë veprë penale duhet ta kryej me dashje dhe të ketë qëllim, që sipas nenit 422 par 1 qëllimi duhet të jetë për të përfituar për vete, për tjetrin apo që t'i shkaktohet dëm personit tjetër.

Kolegji vlerëson se në rastin konkret nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor dhe faktet që prokuroria i pretendon në akuzë në mbështetje të nenit 22, nuk e shpërfaqin dashjen e të pandehurit për të kryer veprën penale dhe nuk shpërfaqet se i pandehuri kishte qëllim për të dëmtuar qoftë komunën e Malishevës apo të dëmtuarin B.R..

Fillimisht kolegji vlerëson se si shkolla ashtu edhe salla e sporteve që ndërlidhen me veprimet e të akuzuarit ishin projekte publike për qëllim të shfrytëzimit të nxënësve në mësim dhe për qëllim të rekreacionit sportiv të nxënësve, në këtë kuptim objektet e tilla nuk ishin të ndërlidhura me interesat e subjekteve private (gjë që as prokuroria nuk ngriste ndonjë fakt se këto objekte ndërlidheshin me interesa të ndonjë subjekti privat). Madje, kolegji vlerëson se rrethanat faktike vërtetojnë mungesën e ekzistimit të dashjes dhe qëllimit të të akuzuarit, sepse i ishte dakorduar me të dëmtuarin B.R. që ai ta lëshonte një pjesë të pronës private për ndërtimin e shkollës edhe pse në kundërshtim me autorizimet e tij, rrethana e tillë nuk rezultojnë se i akuzuari kishte dashje për kryerje të veprës penale. Kjo për faktin se vetë i dëmtuari B.R. ka deklaruar se unë jam dakorduar që ta lëshoj pronën për ndërtimin e shkollës që kam biseduar me të akuzuarin në cilësinë e kryetarit të komunës dhe se ai me ka treguar se prona do të këmbëhet me pronë publike por që duhet të shkojë përmes procedurave të kuvendit të komunës.

Pra vet i dëmtuari pohon se ai kishte dhënë pëlqim por që prona në të ardhmen duhet të kompensohet dhe se vetë i dëmtuari pohon se i akuzuari e kishte njoftuar se prona duhet të këmbëhej përmes kuvendit të komunës, kjo deklaratë e të dëmtuarit në thelb e zhbën ekzistimin e dashjes se akuzuarit, sepse i akuzuari qëllimin e kishte për ndërtimin e shkollës, nga se ai e kishte njoftuar se prona do te kompensohet, se proceduar për këtë kompensim gjegjësisht këmbim te pronës duhet te shkonte përmes kuvendit komunal.

Njëkohësisht kolegji vlerëson se i akuzuari nuk kishte qëllim qe te dëmtarin B.R. ti shkaktonte dëme, nga se siç rezulton nga shkresat e lendes, konkretisht kërkesa e te akuzuarit e datës, 02.10.2028 drejtuar Kuvendit Komunal e pranuar nga Kuvendi me date 06.11.2018, me lëndë, “ Kërkesë për marrjen e vendimit për ndërrimin e pronës publike me pronën private për interes publik me rastin e ndërtimit te shkollës fillore ne fshatin ... Komuna e Malishevës”, kjo kërkesë e parashtruar nga ana e te akuzuarit te organi i cili kishte kompetencë për te vendosur për këmbimin e pronës, e shfaqe përtej çdo dyshimi mungesën e te akuzuarit se kishte qëllim qe ta dëmtoj te dëmtuarin B.R., sepse ai fillimisht e kishte njoftuar se prona e ti iu duhet për ndërtim te shkollës, i akuzuari kishte qëllimin e ndërtimit te shkollës, se i dëmtuari ishte pajtuar qe ta lëshoj një pjese te pronës se tij për ndërtimin e shkollës, se i akuzuari ishte njoftuar se do te kompensohej por se procedura duhet te shkonte përmes kuvendit te komunës, se i akuzuari e kishte parashtruar kërkesën ne përputhje me dispozitat ligjore kërkesën për ndërrimin e pronës publike me atë private për qëllim te interesit publik te ndërtimit te shkollës, se ai kishte konstatuar ne kërkesë qe ndërrimi i pronave te behet ne përputhje me vlerësimet nga organi kompetent.

Fakti se Kuvendi Komunal nuk e kishte proceduar kërkesën e parashtruar nga ana e te dëmtuarit nuk nënkupton se i akuzuari kishte dashje për kryerje te veprës penale apo se kishte qëllim për dëmtimin e te dëmtuarit B.R..

Kolegji vlerëson se, marrë për bazë faktin se mbrojtësi i të dëmtuarit ka parashtruar së bashku me ankesën vendimin Nr. 02/158 te datës 04.04.2022, qe tashme Kuvendi Komunal ka miratuar ndërrimin e pronës publike me atë private, kjo prove vërteton përtej çdo dyshimi mungesën e dashjes se te akuzuarit për te kryer veprën penale posaçërisht vërteton mungesën e qëllimit të të akuzuarit se ai kishte ndonjë qëllim që të dëmtuarin B.R. t'i shkaktonte dëm në raport me të drejtën e tij në pronë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit po ashtu vlerëson se veprimet e të akuzuarit kur kishte marr vendim për caktimin e lokacionit të ndërtimit të sallës së sporteve në fshatin ... në pronën e SH,F,M Visar Krasniqit- pronë publike e jo në pronën e shkollës Bajram Curri – pronë publike që të dy këto shkolla në fshatin ..., gjen se veprimi i të akuzuarit ishte në mos përmbushje të detyrave të tij, sepse ai detyrohej që të zbatonte vendimin e kuvendit të komunës numër 02/135 të datës 04.05.2018, e jo të nxirrte një vendim siç veproj i akuzuari që nxori një vendim tjetër dhe përcaktoj lokacionin për ndërtimin e sallës së sporteve në një hapësirë tjetër të pronës publike.

Megjithatë Kolegji vëren se aktakuza për këtë veprim nuk e ngarkon të akuzuarin se ai kishte përfitime për veti apo për ndonjë person tjetër apo që ishte dëmtuar ndonjë person tjetër, pra vet organi i akuzës nuk përfshin as një rrethanë faktike që do të përbënin elemente të veprës penale në raport me dashjen e të akuzuarit dhe qëllimin, elemente këto që për gjykatën e Apelit përbejnë figurën e veprës penale për të cilën prokuroria e ngarkonte të akuzuarin.

Në tërësinë e akuzës për sa i përket veprimeve të të akuzuarit se ai ka anashkaluar vendimin e kuvendit komunal lidhur me lokacionin e ndërtimit të sallës së sporteve vet organi i akuzës nuk e ngarkon të akuzuarin për këtë veprim se ai kishte qëllim të përfitimit për vete apo për tjetrin apo se kishte qëllim që të dëmtonte personin tjetër.

Andaj kolegji duke pas për bazë se organi i akuzës nuk e kishte ngarkuar të akuzuarin lidhur me qëllimin e tij për sa i përket ndërrimit të lokacionit të sallës së sporteve edhe pse siç u theksuar më lartë veprimi i të akuzuarit përbën mos përmbushje të detyrës ky veprim nuk mund të m'vishet me përgjegjësi penale në mungesë të dashjes dhe qëllimit. Rrjedhimisht mos përmbushja në situatën konkrete bie në domenin e shkeljeve administrative që si të tilla nuk ju jep mbrojtje e drejta penale por ju jep mbrojtje e drejta administrative gjë që në situatën konkrete ekziston organi mbikëqyrës i shkeljes së natyrës administrative që është Ministria e pushtetit lokal e cila sipas ligjit 03/L-040 për vetëqeverisje lokale nenit 74,75 dhe 76 bën mbikëqyrjen e ligjshmërisë së vendimeve, të komunave dhe të kryetarëve të komunave.

Pra kolegji nuk mund të supozoj se me veprimin e të akuzuarit kush kishte pasur përfitim apo dëm kur ai kishte ndërruar lokacionin e ndërtimit të sallës së sporteve sepse për tu konstatuar fajësia thjesht duhet të ekzistoj ky qëllim që dikush të përfitoj apo dikush të dëmtohet e që vet prokuroria nuk e ngarkonte të akuzuarin se ai e kishte ndërruar lokacionin për ndërtimin e sallës së sporteve dhe se me rastin e ndërrimit të këtij lokacionit ai kishte pasur ndonjë qëllim, për më

tepër edhe vet prokuroria ishte e bindur se kur i akuzuari kishte nxjerr vendim për ri caktim të lokacionit të sallës së sporteve në akuzë prokuroria përdor shprehjen “duke anashkaluar vendimin e kuvendit komunal” pra organi i akuzës nuk e ngarkonte për ekzistimin e ndonjë qëllimi apo të dashjes së të pandehurit, por thjesht për shkelje të natyrës administrative që kanë të bëjnë me mos zbatimin e një vendimi të kuvendit të komunës.

Kolegji i gjykatës së Apelit po ashtu vlerëson se lidhur me veprimin që ngarkohej i akuzuari se kishte nxjerr vendimin me datë 26.10.2018, që kishte lejuar lëvizjen e mjeteve nga një kod në një kod tjetër edhe në këtë veprim organi i akuzës nuk e ngarkon të akuzuarin se kishte dikush përfitim apo se dikush ishte dëmtuar. Kolegji, ka parasysh se lëvizja e mjeteve të një institucioni që menaxhon me mjete publike siç është komuna duhet të bëhet me përputhje me ligjin për vet qeverisje lokale dhe se duhet të bëhet miratimi i lëvizjeve të tilla nga kuvendi i komunës, megjithëse në vet akuzën e prokurorisë nuk pretendohet se dikush kishte përfituar apo se dikush ishte dëmtuar, rrethanë kjo që shpërfaq qëllimin e të akuzuarit dhe dashjen e tij për kryerjen e veprës penale në mënyrë që të konstatohet përgjegjësia penale ndaj të akuzuarit, mungesa e pretendimit të akuzës se kush kishte përfituar me rastin e nxjerrjes së vendimit të tillë apo se kush ishte dëmtuar me veprimin e të akuzuarit kur kishte nxjerrë vendimin për lejimin e mjeteve monetare nga një kod në kodin tjetër, e bën që të jetë shkelje e natyrës administrative e jo me karakter të përgjegjësive penale, sepse duke mos specifikuar se kush kishte përfituar dhe kush ishte dëmtuar apo a kishte përfitues apo dëmtues që ndërlidhet me qëllimin e të akuzuarit e që qëllimi është element i kësaj vepre penale që ngarkohej ai, e bënë këtë veprim të të akuzuarit që të jetë në suaza të natyrës së shkeljes administrative.

Fakti se aktakuza e ngarkonte për këtë veprim të akuzuarin “të njëjtat mjete i ka përdorur për pagesën e detyrimeve financiare të komunës ndaj personave të tretë“ kjo më së miri e shpërfaq mungesën e qëllimit të vet akuzuarit se ai kishte përfitim për vete apo për tjetrin që ai kishte qëllim për dëmtim të personave të tjerë, sepse vet organi i akuzës konstaton se detyrimet financiare ishin të komunës, e ato detyrime që i kishte komuna i kishte ndaj personave të tjerë, ndërsa nuk pretendohet as nga akuzë se këto pagesa të personave të tretë ishin pa bazë dhe të kundërligjshme por thjesht se mjetet monetare kishin lëvizur nga një kod në kodin tjetër për qëllim të detyrimeve financiare që i kishte komuna e jo për qëllim që dikush të përfitonte apo dikush të dëmtohej.

Andaj për të gjitha këto arsye kolegji i gjykatës se Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë kur ka administruar provat gabimisht ka nxjerrë konkluzione mbi përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe fajësinë e tij, për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare të kryer në vazhdim nga nenin 422 par 1 lidhur me nenin 81 kur e ka shpallur fajtor, nga se dispozitat e kodit penal përcaktojnë se kjo veprë penale kryhet me veprim (duke tejkaluar kompetencat) apo mos veprim (duke mos i përmbushur detyrat zyrtare), se kjo veprë penale kryhet me dashje, dhe se element thelbësor i figurës së kësaj vepre penale është qëllimi, e neni 22 e KPRK-së përcakton se dashja, apo qëllimi duhet të rezultojë nga rrethanat faktike, gjë që organi i akuzës e ngarkonte të akuzuarin për tri veprime si vazhdimësi të kryerjes së veprës penale, mirëpo vet organi i akuzës në dy këto veprime të të akuzuarit që janë “ndërrimi i lokacionit të ndërtimit të sallës së sporteve, dhe lejimi i lëvizjes së mjeteve monetare nga një kod në kodin tjetër” nuk e ngarkonin të akuzuarin se kishte ndonjë qëllim me rastin e marrjeve të këtyre veprimeve, konkretisht për veprimin lidhur me ndërtimin e shkollës kolegji i gjykatës se Apelit, vlerëson se vet deklarata e të dëmtuarit dhe kërkesa e parashtruar nga i akuzuari drejtuar kuvendit komunal për këmbimin e pronës publike me pronën private për interes të përgjithshëm, si dhe vendimi që tashmë është marr nga kuvendi i komunës për ndërrimin e pronës publike me atë private rrezon çdo pretendim të akuzës se i akuzuari kishte ndonjë qëllim për ta dëmtuar të dëmtuarin B.R.n, ndërsa për ndërrimin e lokacionit të sallës së sporteve nuk rezulton se ajo është ndërtuar por thjesht vendimi i Kuvendit Komunal dhe ai i të akuzuarit jashtë kompetencave që e kishte ndërruar lokacionin asnjëri nuk ishin zbatuar nga se vet akuza konstaton se salla e sporteve nuk është ndërtuar asnjëherë.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të shqyrtuar në shqyrtimin gjyqësor dhe ato provat materiale siç janë procesverbalet e kuvendit komunal. Këto procesverbale nuk vërtetojnë ndonjë rrethane që mund të ndërlidhet me qëllimin apo dashjen e të akuzuarit. Vendimet e kuvendit komunal si të tilla mos zbatimi i këtyre vendimeve mbasin në suaza të mos përmbushjes së detyrave nga i akuzuari megjithatë këto nuk vërtetojnë ndonjë rrethanë lidhur me dashjen apo qëllimin e të akuzuarit.

Kontratat për kryerjen e punëve të lidhura në prokurimin publik – nuk kishte mëdyshje as nga pretendimet e akuzës se kontrata ishte lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore (pasi që nuk pretendohet në akuze) por çështja e kësaj prove ndërlidhet me faktin se ishin kryer punimet për ndërtimin e shkollës që shtrihej në pjesë publike dhe pjesën e pronës private, andaj fakti se punimet ishin kryer nuk mohohej, megjithatë kjo prove nuk vërteton ndonjë rrethanë lidhur me

dashjen e te akuzuarit për kryerje te veprës penale përkatësisht se ai kishte ndonjë qellim për shkaktimin e demit personave te tret qoftë Komunës se Malishevës apo te dëmtuarit B.R..

Pra asnjë nga këto prova ne raport me faktet e pretenduara ne akuzë nuk e vërteton ekzistimin e dashjes apo qëllimit te te akuzuarit për te kryer vepër penale me qellim te përfitimit apo te dëmtimit te personave tjerë, elemente këto qe përbëjnë figurën e veprës penale te keqpërdorimit te detyrës zyrtare.

Gjykata ka vlerësuar edhe ekspertizën e ekspertit financiar, e cila ka konstatuar se me veprimet e te akuzuarit janë krijuar detyrime për komunën. Krijimi i detyrimeve për komunën për kolegjin e gjykatës se apelit është evident, megjithatë detyrimet qe krijohen nuk konsistojnë ne dem pasi qe ishte Komuna ajo qe ndërtimi i shkollës fillore pa dyshim se behej për interes te përgjithshëm, dhe padyshim me rastin e ndërtimit te shkollës dhe këmbimit te pronës nga prona publike ne pronën private, krijohen edhe detyrime, por për te ekzistuar qëllimi për kryerje te veprës penale nuk konsiston qe veprimi te krijoj detyrime por se ato detyrime për çfarë qëllimi krijohen, e qe nga rrethanat faktike rezulton se detyrimet ishin krijuar për qellim te ndërtimit te shkollës dhe jo për qellim te përfitimit apo për qellim te dëmtimit te personave te tjerë qoftë te komunës apo te te dëmtuarit B.R., siç pretendon aktakuza.

Kolegji i gjykatës se Apelit vlerëson se dëmi nuk mund (dem kontingjent) qe nënkupton si dem i papërcaktuar te vepra penale e keqpërdorimit te detyrës zyrtare, siç eksperti ka konstatuar ne ekspertizën financiare kur konstaton se, janë krijuar detyrime kontingjente për Komune, por njëkohësisht qëllimi për te kryer vepër penale duhet te jete primar te kryerësi i veprës penale dhe jo, siç gabimisht gjykata e shkalles se pare ka konstatuar se është krijuar dëm ne raport me komunën dhe te dëmtuarin B.R. nga se ne çdo raport juridik te caktuar mund te ketë edhe dem por çështja shtrohet se veprimet e ndërmarra a janë me qellim te krijimit te dëmit si qellim për kryerje te veprës apo demi eventualisht ka rezultuar nga raporti juridik ndërmjet subjekteve te se drejtës.

Nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor pa përjashtim si dëshmitarët por edhe nga provat materiale, vërtetohet se kishte qene qëllimi i ndërtimit të një shkolle ne fshatin ..., se i akuzuari në cilësinë e kryetarit të Komunës ia kishte sqaruar të dëmtuarit se prona e tij private është e nevojshme për ndërtimin e shkollës se i dëmtuari ishte pajtuar dhe se i akuzuari i kishte treguar se procedurat duhet ndjekur përmes Kuvendit te Komunës ku edhe kishte parashtruar

kërkesën për ndërrimin e pronës, dhe se kuvendi komunal nuk e kishte trajtuar, por se shkolla kishte filluar te ndërtohet.

Fakti se Kuvendi Komunal nuk e kishte trajtuar kërkesën e të akuzuarit kjo nuk e vërteton ekzistimin e qëllimit të të akuzuarit për ta dëmtuar të dëmtuarin B.R. apo Komunën e Malishevës, pasi që i dëmtuari ishte në dijeni se prona nuk ishte këmbyer dhe ai nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për ta ndaluar punimet për shkak se nuk i ishte këmbyer prona, e fakti se Kuvendi Komunal i Malishevës ne vitin 2022 kishte marr vendim me të cilin kishte lejuar këmbimin e pronës private me atë publike e rrezon çdo rrethanë faktike për tu konsideruar se ka ekzistuar qëllimi i të akuzuarit për të shkaktuar dëm Komunës së Malishevës, apo për të shkaktuar dëm ndaj të dëmtuarit B.R..

Gjykata e Apelit, nuk akcepton vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë kur konstaton se çdo shkelje e detyrës zyrtare konsumon veprën penale, por se ky kolegji vlerëson se jo çdo shkelje përkatësisht çdo tejkalim apo çdo mos përmbushje te detyrave zyrtare konsumon veprën penale te Keqpërdorimit te detyrës apo autoritetit nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-ës, por se duhet patjetër që veprimet në shkelje të detyrës zyrtare të manifestohen përmes dashjes se drejtpërdrejt të të akuzuarit, e në rastin konkret përgjegjësia penale duhet të ndërlidhet me qëllimin e kryerësit i cili qellim duhet të manifestohet përmes veprimeve e që përmes veprimeve të vijë deri te manifestimi i qëllimit për përfitim për vete apo tjetrin apo dëmtim të personit tjetër, qëndrim ky i kolegjit tashmë i konsoliduar nga praktika gjyqësore (Pa-II.nr.1/2020) edhe e Gjykatës Supreme.

Ankesa e prokurorisë është jo lëndore, nga se pretendimet e prokurorisë shtriheshin ne raport vetëm me sanksionin penal në ankesë, e duke qene se kolegji i kësaj gjykate ka vendosur si ne dispozitiv te aktgjykimit ku e ka liruar te akuzuarin nga aktakuza, vet pretendimi ankimor i prokurorisë për shqiptimin e një dënimi më të ashpër është i pa objekt, nga se është vërtetuar se i akuzuari nuk është fajtores për veprën penale qe akuzohej.

Andaj për arsyet e theksuara si më lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 403 të KPRK-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

APS.nr.20/2022 me datë 28.07.2022

B. Profesionale
Alba Makolli

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Kryetar i kolegjit,
Bashkim Hyseni

Ferit Osmani
